VENDIM
Nr.24, datë 12.11.2008

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	Kryetar	i Gjykatës	Kushtetuese
Gjergji Sauli	Anëtar	i “	“
Fehmi Abdiu	Anëtar	i “	“
Kristofor Peçi	Anëtar	i “	“
Xhezair Zaganjori	Anëtar	i “	“
Petrit Plloçi	Anëtar	i “	“
Sokol Berberi	Anëtar	i “	“
Kujtim Puto	Anëtar	i “	“

me sekretare Brunilda Bara, në datë 17.1.2008, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.57/11 Akti, që i përket:

KËRKUES: Pavllo Kisi dhe Maria Kisi, përfaqësuar nga av.Flonia Tashko Boriçi, me prokurë.

SUBJEKTI I INTERESUAR: Vasilika Leka, përfaqësuar nga av.Dashamir Kore, me prokurë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimit nr.66, datë 28.4.2005 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe i vendimit nr.4, datë 23.1.2007 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f e 134 të Kushtetutës, si dhe neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Kujtim Puto, përfaqësuesin e kërkuesve që u shpreh për pranimin e kërkesës; përfaqësuesin e subjektit të interesuar që kërkoi rrëzimin e kërkesës dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Kërkuesit Pavllo Kisi dhe Maria Kisi janë fëmijët e Petro Kisit, vëllait të vetëm të trashëgimlënëses Marie Leka (Kisi), kurse subjekti i interesuar Vasiliqi (Vasilika) Leka është vajza nga martesa e dytë e bashkëshortit pasjetues të trashëgimlënëses, i quajtur Aristidh Leka. Trashëgimlënësja Maria Leka (Kisi) ka vdekur në 19.7.1944 dhe nuk ka lënë as fëmijë e as testament.

Gjykata Popullore e Rrethit Durrës, me vendimin nr.184, datë 11.3.1961, i lënë në fuqi me vendimin nr.114, datë 25.4.1961 të Gjykatës së Qarkut Durrës ka vendosur, që ati i kërkuesve, i quajturi Petro Kisi, të njihet trashëgimtar ligjor i motrës së tij, trashëgimlënëses Maria Leka (Kisi) në 4/8 pjesë të pasurisë së saj. Në përcaktimin e pjesës së tij trashëgimore gjykatat janë bazuar në dekretin nr.1892, datë 5.7.1954 “Mbi trashëgiminë” (i ndryshuar), sipas të cilit, në pasuritë e papjesëtuara trashëgimtarët e gjakut marrin gjysmën e trashëgimit.

Në gjykimin e padisë së ngritur nga kërkuesit me objekt detyrimin e subjekteve të interesuara që të njohin të drejtën e tyre trashëgimore mbi vilën nr.27, të ndodhur në rrugën “Nikole Tupe” Tiranë, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.56, datë 23.9.2002 kanë vendosur lënien në fuqi të vendimit nr.172, datë 22.1.1996 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për pjesën që detyron subjektet e interesuara të njohin të drejtën trashëgimore të kërkuesve mbi këtë pronë. Për sa i përket të drejtës së pronësisë, gjykatat, duke iu referuar dhe duke interpretuar dispozitat e Kodit Civil të vitit 1929, kanë pranuar në këtë çështje, se banesa është pronë vetëm e trashëgimlënëses Maria Leka (Kisi) dhe figuronte e tillë në dokumentet e zyrës së hipotekës. Për sa i përket të drejtës trashëgimore, gjykatat kanë përcaktuar se ligji në bazë të së cilit do të njihej e drejta

trashëgimore e kërkuesve mbi pasurinë e trashëgimlënëses do të ishte po Kodi Civil i vitit 1929, sipas të cilit, në rast vdekje të bashkëshortit pa fëmijë, trashëgimtarët e gjakut përfitojnë 2/3 e pasurisë së tij.

Mbi padinë e kërkuesve me objekt pjesëtimin e pasurisë, konkretisht të banesës së mësipërme, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.7573, datë 24.12.2004, ka pranuar se pronare e vetme e kësaj banese ishte trashëgimlënësja dhe ka vendosur lejimin e pjesëtimit mbi këtë pasuri duke u njohur kërkuesve 2/3 pjesë, ndërsa subjektit të interesuar 1/3 pjesë të saj. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.66, datë 28.4.2005 e ka ndryshuar vendimin e gjykatës së rrethit duke i njohur kërkuesit bashkëpronarë në 2/6 pjesë, kurse subjektin e interesuar në 4/6 pjesë të banesës. Gjykata e apelit, në përcaktimin e së drejtës së pronësisë i është referuar dispozitave të Kodit Civil të vitit 1929 dhe, duke bërë një interpretim të ndryshëm nga interpretimi i mëparshëm i Kolegjeve të Bashkuara që njihte trashëgimlënësen si pronare të vetme, ka arritur në përfundimin se banesa ka qenë send në bashkëpronësi ndërmjet trashëgimlënëses dhe bashkëshortit të saj. Për sa i përket pjesës trashëgimore, gjykata e apelit i është referuar vendimit të vitit 2002 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë duke zbatuar Kodin Civil të vitit 1929, sipas të cilit, trashëgimtarët e gjakut përfitojnë 2/3 pjesë dhe jo dekretit nr.1892, datë 5.7.1954 "Mbi trashëgiminë" (i ndryshuar), sipas të cilit, pjesët trashëgimore duhet të jetë të barabarta. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur dërgimin e çështjes në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë për njësimin e praktikës gjyqësore.

Me gjithë kërkesën e Kolegjit Civil, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.4, datë 23.1.2007 nuk kanë pranuar të unifikojnë praktikën gjyqësore, por kanë zgjidhur çështjen konkrete duke iu dhënë përgjigje pretendimeve të ngritura nga palët në gjykim. Në përfundim, Kolegjet e Bashkuara kanë lënë në fuqi vendimin e gjykatës së apelit duke u caktuar kërkuesve 2/6 pjesë në banesë, ndërsa subjektit të interesuar 4/6 pjesë. Ato arsyetojnë në vendim se për këtë përfundim janë bazuar në vendimin nr.184, datë 11.3.1961 të Gjykatës Popullore të Rrethit Durrës që i përcakton si të barabarta pjesët trashëgimore të palëve, duke u bazuar në dekretin nr.1892, datë 5.7.1954 "Mbi trashëgiminë" (i ndryshuar).

Kërkuesit, bazuar në nenin 42 dhe 131, germa f të Kushtetutës, i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese dhe kanë kërkuar shfuqizimin e vendimit nr.66, datë 28.4.2005 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe të vendimit nr.4, datë 23.1.2007 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë duke parashtruar këto pretendime:

- Vendimet e Gjykatës së Apelit Tiranë dhe të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, objekt kundërshtimi, kanë cenuar parimin e sigurisë juridike, sepse bien në kundërshtim me qëndrimin e mbajtur nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në vendimin nr.56, datë 23.9.2002. Në këtë vendim është pranuar se e drejta e pronësisë dhe pjesët trashëgimore do të rregullohen nga dispozitat e Kodit Civil të vitit 1929 dhe jo nga dekreti "Për trashëgiminë" i vitit 1954 (i ndryshuar). Si rrjedhojë, banesa është pronë vetëm e trashëgimlënëses Maria Kisi.

Kërkuesit pretendojnë se me vendimin nr.56, datë 23.9.2002 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë janë njohur pronarë në 2/3 pjesë të pronës objekt pjesëtimi, ndërsa me vendimin nr.66, datë 28.4.2005 të Gjykatës së Apelit Tiranë, lënë në fuqi nga vendimi nr.4, datë 23.1.2007 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, pjesa e tyre takuese është zvogëluar në 1/3 pjesë. Kërkuesit i referohen edhe vendimit nr.9, datë 26.2.2007 të Gjykatës Kushtetuese ku pranohet cenimi i parimit të sigurisë juridike nga mohimi i një të drejte të fituar me një ligj të mëparshëm. Sipas tyre, ky parim duhet të shtrihet edhe në rastet e mohimit të një të drejte të fituar me një vendim gjyqësor të formës së prerë.

- Është cenuar parimi i gjykimit nga një gjykatë e krijuar me ligj. Sipas kërkuesve, me termin "gjykatë e krijuar me ligj" si element i procesit të rregullt, nuk duhet kuptuar vetëm gjykata në kuptimin e organizimit të përgjithshëm gjyqësor, por edhe gjykata si trup gjykues në gjykimin e një çështjeje. Sipas tyre, çështjes nuk duhet t'i ishte dhënë zgjidhje nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, por nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, përderisa Kolegjet e Bashkuara konkluduan se nuk do të njësonin praktikën gjyqësore. Sipas tyre ky qëndrim vjen në kundërshtim me nenin 141/2 të Kushtetutës dhe me vendimin nr.46, datë 28.6.1999 të Gjykatës Kushtetuese.

Subjekti i interesuar parashtroi këto prapësime:

- Çështja nuk i takon juridiksionit kushtetues, pasi nuk janë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e së drejtës së pretenduar si e shkelur, kërkesë kjo e nenit 131, germa f e Kushtetutës. Objekti i gjykimit është pjesëtimi i pasurisë, çka do të thotë që vendimi dhe gjykimi përfundimtar i padisë së pjesëtimit gjyqësor është vendimi dhe gjykimi që i jep fund regjimit të bashkëpronësisë. Vendimi mbi fazën e parë të këtij gjykimi nuk është përfundimtar, por vetëm i hap rrugë fazës së dytë, gjykimi e vendimi i së cilës është përfundimtar.

- Nuk ka cenim të parimit të sigurisë juridike, pasi nuk është e vërtetë që vendimi nr.56, datë 23.9.2002 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë i ka njohur kërkuesit bashkëtrashëgimtarë në 2/3 pjesë të banesës. As në vendimin nr.172, datë 22.1.1996 të gjykatës së rrethit dhe as në vendimin nr.56, datë 23.9.2002 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së e Lartë që e ka lënë atë pjesërisht në fuqi, nuk është përcaktuar madhësia e këtyre pjesëve ideale. Pjesët ndërmjet ndërgjyqësve janë përcaktuar me vendimin nr.184, datë 11.3.1961 të Gjykatës Popullore të Rrethit Durrës, (vendim i formës së prerë). Në këtë të fundit, i quajturi Petro Kisi, i ati i kërkuesve, është njohur trashëgimtar i motrës së tij Marie Leka (Kisi) në gjysmën e pasurisë së saj. Referimi i kërkuesve në vendimin nr.9, datë 26.2.2007 të Gjykatës Kushtetuese është krejt i pasaktë, pasi, në rastin në shqyrtim, nuk kërkohet shfuqizimi si antikushtetues i një ligji, por i një vendimi gjyqësor.

- Nuk ka cenim të parimit të gjykimit të çështjes nga një gjykatë e krijuar me ligj, pasi Gjykata e Lartë edhe kur gjykon në kolegje të thjeshta, edhe kur gjykon në Kolegje të Bashkuara, është gjykatë e krijuar me ligj. Vendimi i marrë nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë për dërgimin e kësaj çështjeje për gjykim në Kolegjet e Bashkuara, është plotësisht i mbështetur në nenin 141/2 të Kushtetutës, në nenin 481 të Kodit të Procedurës Civile, si dhe në ligjin "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë" . Edhe sikur të pranohet pretendimi i kërkuesve se çështja duhet të shqyrtohej nga Kolegji Civil dhe jo nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nuk kemi cenim të standardit, përkundrazi, është rritur garancia për palët në gjykim.

II

1. Gjykata Kushtetuese (Gjykata) e sheh me vend që, përpara se të shqyrtojë bazueshmërinë e pretendimeve të palëve rreth themelit të çështjes, të analizojë paraprakisht pretendimin e subjektit të interesuar, sipas të cilit, Gjykata Kushtetuese nuk është kompetente për shqyrtimin e kërkesës, përderisa nuk ka mbaruar shqyrtimi i fazës së dytë të pjesëtimit në gjykatat e sistemit të zakonshëm dhe kërkuesi nuk ka shterur mjetet e ankimit në ato gjykata. Në lidhje me këtë konstatohet se vendimet që janë kundërshtuar në Gjykatën Kushtetuese janë dhënë mbi bazën e padisë për pjesëtimin e pasurisë trashëgimore. Gjykimi për pjesëtimin e pasurisë trashëgimore, apo sendeve në bashkëpronësi, është një nga llojet e gjykimeve të posaçme që parashikohen nga Kodi i Procedurës Civile. Megjithëse gjykimi për pjesëtimin e pasurisë trashëgimore iniciohet nga një padi, e cila në thelb kërkon t'i japë fund regjimit të bashkëpronësisë, Kodi i Procedurës Civile parashikon se ky proces gjykimi realizohet në dy faza. Faza e parë e gjykimit ka për objekt shqyrtimi përcaktimin e rrethit të bashkëpronarëve, sendet që do të pjesëtohen dhe pjesët takuese të bashkëpronarëve mbi sendet objekt pjesëtimi, ndërsa me vendimin e fazës së dytë bëhet ndarja në natyrë e sendeve objekt pjesëtimi.

Gjykata, bazuar në dispozitat procedurale që rregullojnë gjykimin e pjesëtimit gjyqësor dhe interpretimin që u kanë bërë këtyre dispozitave Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në vendimin unifikues nr.628, datë 15.5.2000 konstaton se çështjet që zgjidhen në fazën e parë të këtij gjykimi nuk mund të bëhen objekt shqyrtimi gjyqësor në fazën e dytë, fazë e cila fillon kur vendimi i fazës së parë ka marrë formë të prerë. Nisur nga sa më sipër, Gjykata arrin në konkluzionin se vendimi i fazës së parë të pjesëtimit është një vendim përfundimtar për problemet që ngrihen në Gjykatën Kushtetuese dhe si rrjedhojë nuk pranohet që kërkuesi nuk i ka shterur mjetet juridike për mbrojtjen e të drejtave në kuptim të nenit 131, germa f të Kushtetutës. Prandaj, çështja në shqyrtim është në juridiksionin e saj.

2. Në kërkesën e tyre drejtuar Gjykatës Kushtetuese kërkuesit parashtrojnë në thelb pretendimin e cenimit të parimit të sigurisë juridike dhe atë të gjykimit nga një gjykatë e krijuar me ligj.

2.1 Gjykata Kushtetuese, në disa vendime të saj ka pranuar se siguria juridike është ndër elementet thelbësore të shtetit të së drejtës dhe kjo siguri presupozon, veç të tjerash, besueshmërinë e qytetarëve tek shteti dhe pandryshueshmërinë e ligjit për marrëdhëniet e rregulluara. Ndërsa, në vendimin nr.9, datë 26.2.2007 ajo ka zbërthyer më tej konceptin e besueshmërisë, duke theksuar se ajo "ka të bëjë me bindjen e individit se nuk duhet të shqetësohet vazhdimisht ose të jetojë me frikë për ndryshueshmërinë dhe pasojat negative të akteve juridike, të cilat mund të cenojnë jetën e tij private ose profesionale dhe të përkeqësojnë një gjendje të vendosur me akte të mëparshme".

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në nenin 42 të saj shpall parimin e moscenimit të lirisë së pronës dhe të të drejtave të njohura me Kushtetutë e me ligj pa një proces të rregullt ligjor, duke garantuar njëkohësisht të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës për mbrojtjen e këtyre të drejtave dhe lirive. Në harmoni me parimin e sigurisë juridike, ligji procedural civil ka sanksionuar edhe parimin e gjësë së gjykuar (*res judicata*), parim që pengon dhënien e çdo vendimi të ri mbi atë që është gjykuar. Sipas nenit 451/a të Kodit të Procedurës Civile, kur vendimi ka marrë formë të prerë ai është i detyrueshëm për palët, trashëgimtarët e tyre, për personat që tërheqin të drejta nga palët, për gjykatën që ka dhënë vendimin dhe për të gjitha gjykatat dhe institucionet e tjera. Asnjë gjykatë nuk mundet të gjykojë sërish të njëjtën padi kundrejt të njëjtave palë.

Gjykata çmon se vendimi gjyqësor i formës së prerë që përbën gjë të gjykuar është shprehje e konkretizim i së drejtës mbi marrëdhënien juridike dhe ka qëllim t'i japë jo vetëm qartësi, por dhe siguri kësaj marrëdhënie. Cenimi i parimit të gjësë së gjykuar do të çonte në cenimin e të drejtave, lirive dhe interesave kushtetuese e ligjore të garantuara nga neni 42 i Kushtetutës, pra në cenim të vetë sigurisë juridike. Prandaj, në vendimin nr.23, datë 8.6.2007 ajo ka pranuar se "...vlerësimi dhe arsyetimi nga ana e gjykatave, lidhur me vendimin gjyqësor të paraqitur si provë nga ana e kërkuesit ka rëndësi dhe në kuadrin e respektimit të parimit të sigurisë juridike, si një nga aspektet themelore të shtetit të së drejtës. Siguria juridike nënkupton, ndërmjet të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit tek shteti, institucionet e tij dhe tek aktet që ato nxjerrin. Ndërsa, në kontekstin e çështjes në shqyrtim, siguria juridike nënkupton që, në rastet kur gjykata ka vendosur përfundimisht për një çështje, vendimi i saj nuk duhet të vihet në dyshim".

Të njëjtin qëndrim ka mbajtur dhe Gjykata Europiane e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, e cila në çështjen Kehaya and others v. Bulgaria shprehet se "...në pikëpamjen e Gjykatës, parimi në bazë të së cilit një vendim përfundimtar i formës së prerë, është gjë e gjykuar dhe zgjidh mosmarrëveshjen midis palëve me një vendim përfundimtar është një element themelor i së drejtës për një gjykim të drejtë që garantohet nga neni 6 i Konventës në çështjet civile. Parimi i sigurisë juridike dikton që kur një mosmarrëveshje civile është shqyrtuar në themel nga gjykatat, ajo duhet të vendoset një herë e përgjithmonë".

Bazuar në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese dhe në standardin e vendosur nga Gjykata Europiane e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, Gjykata Kushtetuese vlerëson se kufijtë e zbatimit të parimit të gjësë së gjykuar përcaktohen në lidhje të ngushtë me thelbin e mosmarrëveshjes në gjykim. Në këtë aspekt, Gjykata Kushtetuese çmon se gjëja e gjykuar përfshin jo vetëm urdhërimet e dispozitivit të vendimit gjyqësor, por dhe vërtetimet e fakteve dhe zbatimin e së drejtës, të përcaktuara në pjesën përshkruese arsyetuese të vendimit me kusht, që të jenë kryer me qëllim të dhënies së vendimit gjyqësor dhe t'i përkasin fakteve ose marrëdhënieve që kanë formuar objektin e gjykimit mbi të cilin gjykata ka dhënë vendimin e saj.

Gjykata Kushtetuese konstaton se padia mbi bazë të së cilës është dhënë vendimi i mëparshëm nr.56, datë 23.9.2002 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë ka pasur për objekt njohjen e së drejtës trashëgimore të kërkuesve mbi pasurinë e trashëgimlënëses dhe konkretisht, mbi vilën nr.27 të ndodhur në rrugën "Nikole Tupe", Tiranë. Për këtë arsye, pjesë e domosdoshme e këtij gjykimi ka qenë dhe hetimi e vërtetimi i faktit nëse prona, objekt gjykimi, ka qenë apo jo pronë tërësisht apo pjesërisht e trashëgimlënëses Maria Leka (Kisi). Gjithashtu, çështje e domosdoshme e këtij gjykimi ka qenë edhe përcaktimi i ligjit në bazë të të cilit do të njihej pjesa trashëgimore e kërkuesve mbi pasurinë e trashëgimlënëses. Në lidhje me faktin se në pronësi të kujt ka qenë banesa objekt mosmarrëveshje, kërkuesit kanë pretenduar se kjo pronë ka qenë në pronësi të trashëgimlënëses, ndërsa subjektet e interesuara kanë pretenduar se kjo pronë ka qenë në pronësi të bashkëshortit të saj Aristidh Leka,

trashëgimlënësit të subjekteve të interesuara. Në fund të këtij gjykimi gjykatat, bazuar në Kodin Civil të vitit 1929, kanë pranuar përfundimisht faktin juridik se banesa objekt gjykimi, ka qenë tërësisht pronë e trashëgimlënëses Maria Leka (Kisi). Gjykatat kanë konkluduar gjithashtu se për caktimin e pjesëve trashëgimore ndërmjet ndërgjyqësve do të merrej për bazë Kodi Civil i vitit 1929, sipas të cilit trashëgimtarët e gjakut përfitojnë 2/3 pjesë dhe jo dekreti nr.1892, datë 5.7.1954 "Mbi trashëgiminë" (i ndryshuar), sipas të cilit, si bashkëshorti, ashtu edhe trashëgimtarët e gjakut përfitojnë në pjesë të barabarta nga 1/2 pjesë secili.

Subjekti i interesuar, duke mos pranuar në Gjykatën Kushtetuese cenimin e parimit të sigurisë juridike, ka pretenduar se nuk është e vërtetë që vendimi nr.56, datë 23.9.2002 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë i ka njohur kërkuesit bashkëtrashëgimtarë në 2/3 pjesë të pasurisë trashëgimore. Sipas tij, si në vendimin nr.172, datë 22.1.1996 të gjykatës së rrethit, ashtu dhe në vendimin nr.56, datë 23.9.2002 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nuk është përcaktuar madhësia e këtyre pjesëve ideale.

Në lidhje me këtë prapësim kërkuesit kanë pretenduar se pjesët takuese janë përcaktuar dhe dalin nga arsyetimi i vendimit të formës së prerë nr.56, datë 23.9.2002 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Sipas kërkuesve, në bazë të nenit 142 të Kushtetutës, arsyetimi i vendimit është detyrim kushtetues, ndërsa bazuar në nenin 310 të Kodit të Procedurës Civile, pjesa arsyetuese e vendimit është një nga pjesët e vendimit gjyqësor civil, i cili së bashku me pjesët e tjera duhet të merret si një i tërë dhe i pandarë.

Për sa i përket këtij argumenti, Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj nr.33, datë 8.12.2005 është shprehur se "...vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara, të lidhura logjikisht dhe të respektojnë rregullat dhe ligjet e mendimit të drejtë. Këto argumente duhet të jenë gjithashtu të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese. Nga ana tjetër, pjesa urdhëruese e vendimit të gjykatës duhet të jetë rezultat i natyrshëm i përfundimeve të arritura në pjesën arsyetuese. Ajo është sintezë e këtyre përfundimeve dhe si e tillë, në asnjë rast, nuk mund të jetë në kundërshtim me to."

Bazuar në jurisprudencën kushtetuese Gjykata vëren se megjithëse në dispozitivin e vendimit nr.172, datë 22.1.1996 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë nuk shprehet për pjesët takuese të trashëgimtarëve, përcaktimi konkret i tyre del jo vetëm nga pjesa arsyetuese e vendimit nr.56, datë 23.9.2002 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, por edhe nga vetë referimi i gjykatës tek nenet 474 dhe 487 të Kodit Civil të vitit 1929 që duhen zbatuar në këtë rast. Gjykatat e mësipërme, në lidhje me të drejtën e pronësisë gjatë këtij gjykimi, duke interpretuar dispozitat e Kodit Civil të vitit 1929, kanë pranuar faktin se trashëgimlënësja Maria Leka (Kisi) ka qenë pronare e vetme e banesës objekt gjykimi. Gjithashtu gjykatat, bazuar në dispozitat e lartpërmendura të Kodit Civil të vitit 1929, si dhe në faktin që Petro Kisi është trashëgimtar i vetëm në lidhje gjaku i trashëgimlënëses, arsyetojnë se këtij i takojnë 2/3 pjesë të banesës, ndërsa subjekteve të interesuara, si trashëgimtarë të bashkëshortit pasjetues, 1/3 pjesë e kësaj pasurie. Nga ky këndvështrim Gjykata Kushtetuese vlerëson se vendimi nr.56, datë 23.9.2002 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, për pjesën që detyron subjektet e interesuara të njohin të drejtën trashëgimore të kërkuesve mbi pasurinë e të ndjerës Maria Leka (Kisi) është i qartë.

Në lidhje me padinë, mbi bazën e së cilës janë dhënë vendimet gjyqësore objekt kundërshtimi, Gjykata Kushtetuese konstaton se, këto vendime kanë të bëjnë me fazën e parë të gjykimit të pjesëtimit gjyqësor. Për këtë arsye, Gjykata e sheh të nevojshme që të theksojë edhe një herë çështjet që duhet të zgjidhë faza e parë e këtij gjykimi, të cilat në bazë të e nenit 370 të Kodit të Procedurës Civile janë hetimi dhe përcaktimi i së drejtës së bashkëpronësisë së ndërgjyqësve, pjesët takuese të tyre dhe sendet që do të pjesëtohen. Gjykata çmon se në një gjykim pjesëtimi, përcaktimi i rrethit të bashkëpronarëve është i lidhur në mënyrë të pandashme me përcaktimin e sendeve që do të pjesëtohen. Gjatë këtij gjykimi objekti i pjesëtimit është i njëjti send i paluajtshëm që ka qenë objekt gjykimi edhe në padinë për njohjen e së drejtës trashëgimore të kërkuesve mbi pasurinë e Maria Lekës (Kisi). Në lidhje me rrethin e trashëgimtarëve bashkëpronarë, gjykatat e sistemit gjyqësor kanë konkluduar se banesa do të pjesëtohet vetëm ndërmjet palëve ndërgjyqëse, kërkuesve si trashëgimtarë të gjakut të trashëgimlënëses dhe subjektit të interesuar si trashëgimtare e bashkëshortit të trashëgimlënëses.

Gjykata e apelit, në vendimin nr.66, datë 28.4.2005, në përcaktimin e pjesës së pronësisë në banesë, në ndryshim nga sa ishte vërtetuar dhe njohur në gjykimet e vitit 2002 ka arritur në përfundimin, se banesa ka qenë send në bashkëpronësi ndërmjet trashëgimlënëses dhe bashkëshortit të saj, gjë që ka ndikuar në madhësinë e pjesës që do t'u takonte kërkuesve. Përsa i përket pjesës trashëgimore, gjykata e apelit i është referuar vendimit të vitit 2002 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë duke pranuar indirekt zbatimin e Kodit Civil të vitit 1929, pra që trashëgimtarët e gjakut përfitojnë 2/3 pjesë dhe jo të dekretit nr.1892, datë 5.7.1954 "Mbi trashëgiminë" (i ndryshuar), sipas të cilit, pjesët trashëgimore duhet të jenë të barabarta. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë lënë në fuqi vendimin e gjykatës së apelit.

Gjykata Kushtetuese, duke i krahasuar vendimet e mëparshme me vendimet objekt kundërshtimi vëren se gjykimi me objekt njohjen e së drejtës trashëgimore mbi banesën i vitit 2002 është një gjykim njohjeje dhe vërtetimi me qëllim që të krijohet apo të ndryshohet bashkëpronësia, ndërsa gjykimi i fazës së parë të pjesëtimit është një gjykim gjithashtu njohës dhe vërtetues, por që ka qëllim t'i japë fund regjimit të bashkëpronësisë. Megjithatë, thelbi i mosmarrëveshjeve të vendosura me vendimin nr.56, datë 23.9.2002 të Kolegjeve të Bashkuara dhe me vendimin nr.4, datë 23.1.2007 të këtyre Kolegjeve është i njëjtë. Ai konsiston në përcaktimin e faktit se në pronësi të kujt ka qenë vila nr.27, ndodhur në rrugën "Nikolla Tupe" Tiranë dhe në bazë të kujt ligji material do të rregullohej trashëgimia ligjore e Maria Leka (Kisi). Në të dyja gjykimet palët, objekti dhe shkaku kanë qenë të njëjtë. Por, Gjykata Kushtetuese konstaton se zgjidhjet që gjykatat e sistemit gjyqësor u kanë dhënë, kanë qenë të ndryshme.

Gjatë gjykimit kushtetues, subjekti i interesuar ka pretenduar gjithashtu se pjesët ndërmjet ndërgjyqësve janë përcaktuar që me vendimin nr.184, datë 11.3.1961 të Gjykatës Popullore të Rrethit Durrës, sipas të cilit trashëgimtari i kërkuesve, Petro Kisi, është njohur trashëgimtar i Maria Leka (Kisit), në 4/8 pjesë të pasurisë së saj. Në lidhje me këtë pretendim Gjykata Kushtetuese konstaton se vendimi nr.184, datë 11.3.1961 i Gjykatës Popullore të Rrethit Durrës ka pasur për objekt përcaktimin e pjesëve ideale takuese të pasurisë trashëgimore të Marie Leka (Kisit) në përgjithësi, pa përcaktuar pasurinë konkrete të lënë trashëgim prej saj. Ky vendim nuk ka pasur për objekt verifikimin e pronësisë apo bashkëpronësisë të banesës, objekt mosmarrëveshje. Veç kësaj, ky fakt juridik nuk mund të bëhej pjesë e hetimit dhe shqyrtimit gjyqësor edhe për arsye se në atë kohë kjo pasuri ishte e shtetëzuar.

Subjekti i interesuar pretendoi gjithashtu se vendimi nr.56, datë 23.9.2002 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë bie në kundërshtim me vendimin nr.184, datë 11.3.1961 të Gjykatës Popullore të Rrethit Durrës për sa i përket ligjit që duhet të zbatohet në përcaktimin e pjesëve të trashëgimisë ligjore. Kjo e fundit i ka njohur palët bashkëtrashëgimtarë në pjesë të barabarta në pasurinë trashëgimore duke u bazuar në dekretin "Për trashëgiminë" të vitit 1954 (i ndryshuar). Lidhur me këtë pretendim Gjykata Kushtetuese konstaton se vendimi i lartpërmendur i Kolegjeve të Bashkuara nuk është kundërshtuar në Gjykatën Kushtetuese nga subjekti i interesuar, dhe si rrjedhojë, duke ngelur i pacenuar, prevalon në pasojat që sjell.

Sa më sipër, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se vendimet objekt kërkese janë rrjedhojë e një procesi jo të rregullt ligjor në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës e nenit 6 të KEDNJ. Ato kanë cenuar parimin e sigurisë juridike duke i hequr efektet ligjore vendimit të formës së prerë nr.56, datë 23.9.2002 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë që ka lënë në fuqi vendimin nr.172, datë 22.1.1996 të Gjykatës së Rrethit Tiranë.

2.2. Kërkuesi ka pretenduar gjithashtu se Gjykata e Lartë ka cenuar dhe parimin e gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj, sepse çështjes nuk duhej t'i jepej zgjidhje nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, por nga Kolegji Civil i saj.

Gjykata Kushtetuese konstaton se gjatë shqyrtimit të rekursit të kërkuesve, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë vendosi ta dërgojë çështjen në Kolegjet e Bashkuara të asaj gjykate për njësimin e praktikës gjyqësore. Këto të fundit, megjithëse vendosën të mos njësojnë praktikën gjyqësore, por vetëm të verifikojnë shkaqet e ngritura në rekurs dhe pretendimet e palëve, i dhanë vetë zgjidhje çështjes dhe nuk ia kthyen atë Kolegjit Civil.

Jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese ka pranuar si cenim të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor shqyrtimin e çështjes nga një gjykatë jo kompetente, por në çështjen në shqyrtim nuk u dhanë argumente të mjaftueshme kushtetuese për ta mbështetur këtë pretendim.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131/f të Kushtetutës dhe nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë",

VENDOSI:

- Shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr.4, datë 23.1.2007 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë dhe të vendimit nr.66, datë 28.4.2005 të Gjykatës së Apelit Tiranë.
- Dërgimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Apelit Tiranë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Vladimir Kristo (kryetar), Gjergj Sauli, Kristofor Peçi, Kujtim Puto, Sokol Berberi.

Anëtarë kundër: Fehmi Abdiu, Petrit Plloçi, Xhezair Zaganjori.

MENDIM PAKICE

Jemi kundër qëndrimit të shumicës. Mendoj se kërkesa e kërkuesve Pavllo e Maria Kisi, me objekt: "Shfuqizimi si antikushtetuese i vendimeve nr.66, datë 28.4.2005 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.4, datë 23.1.2007 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë" është e pambështetur në nenet 131/f e 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Kërkuesit kanë pretenduar se gjykatat kanë prekur parimin e sigurisë juridike duke arsyetuar se me vendimin nr.56, datë 23.9.2002 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, trashëgimtarët e Maria Lekës janë njohur bashkëpronarë në 2/3 pjesë të pasurisë së saj, ndërsa me vendimin nr.66, datë 28.4.2005 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe me vendimin nr.4, datë 23.1.2007 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë u është mohuar kjo e drejtë e njohur më parë me vendimin e lartpërmendur.

Në të vërtetë, nga aktet bashkëngjitur rezulton, se me vendimin nr.56, datë 23.9.2002 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nuk është vendosur njohja e kërkuesve si bashkëpronarë të një vile 2-katëshe, me sipërfaqe trualli prej 800 m^2, si pronë e Maria Kisit, në masën 2/3 pjesë e kësaj pasurie, por është vendosur prishja e vendimit nr.1550, datë 30.10.1996 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Kasacionit dhe të vendimit nr.2767, datë 3.5.1996 të Gjykatës së Apelit Tiranë. Gjithashtu, është vendosur lënia në fuqi e vendimit nr.172, datë 22.1.1996 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për pjesën që detyron të paditurit të njohin të drejtën trashëgimore të të paditurve mbi pasurinë e së ndjerës Marie Leka, si dhe rrëzimin e padisë dhe pushimin e gjykimit për pjesët e tjera të tyre, me arsyetimin se padia nuk mund të ngrihej.

Pra, me këtë vendim nuk është vendosur njohja e paditësve "Kisi" si pronarë të 2/3 pjesë të pasurisë në fjalë, por është lënë në fuqi vendimi nr.172, datë 22.1.1996 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë vetëm për pjesën që ka vendosur njohjen e paditësve si trashëgimtarë mbi pasurinë e të ndjerës Maria Leka, pa përcaktuar pjesën e tyre në këtë bashkëpronësi.

Edhe në vendimin nr.172, datë 22.1.1996 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ndryshe nga sa pretendojnë kërkuesit, është vendosur pranimi i kërkesëpadisë dhe detyrimi i palës së paditur t'u njohë të drejtën trashëgimtarëve të Petro Kisit mbi pasurinë e Maria Lekës, pa përcaktuar se i njeh trashëgimtarë në 2/3 pjesë të kësaj pasurie. Sa u parashtrua, në vendimin nr.172, datë 22.1.1996 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor as në vendimin nr.56, datë 23.9.2002 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nuk është përcaktuar konkretisht sa është madhësia e këtyre pjesëve ideale.

Në këto rrethana, nuk kemi cenim të parimit të sigurisë juridike, sepse nuk kemi dy vendime gjyqësore që i kanë dhënë zgjidhje të ndryshme të njëjtës çështje. Parimi i sigurisë nënkupton detyrën e shtetit për të siguruar besim dhe qëndrueshmëri të rregullimeve ligjore për të mbrojtur të drejtat e

fituara, si dhe respektimin e interesave dhe pritshmërive të ligjshme. Qëllimi i këtij parimi është të garantojë besimin e personave tek shteti.

Nga analiza e këtij parimi mund të nënvizohen 2 aspekte. Së pari: Rëndësia e parimit të sigurisë juridike presupozon disa kërkesa të detyrueshme për rregullimin ligjor në vetvete. Ky rregullim duhet të jetë i qartë dhe harmonik, normat ligjore duhet të jenë të formuluara saktë. Aktet ligjore të nivelit më të ulët nuk duhet të konfliktohen me aktet e një niveli më të lartë, dhe aq më pak me Kushtetutën. Aktet normative duhet të shpallen sipas procedurës së përcaktuar dhe të gjitha entitetet, në raporte të ligjshme mes tyre, duhet të kenë një mundësi për t'u familjarizuar me to. Së dyti: Parimi i sigurisë juridike përfshin gjithashtu disa kërkesa në lidhje me vlefshmërinë e rregullimeve ligjore. Sipas këtij parimi, rregullimi ligjor mund të ndryshohet vetëm në përputhje me parimet dhe normat e Kushtetutës, duke siguruar vazhdimësinë e jurisprudencës.

Parimi i sigurisë juridike duhet të zbatohet nga të gjitha institucionet e autoritetit shtetëror dhe mbi të gjitha nga Kuvendi, që nxjerr ligjet. Është rëndësi thelbësore që ligjvënësi, ndërsa rregullon zbatimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të parashikuara në Kushtetutë, të ndjekë këtë parim, me qëllim që situata ligjore në të cilën ndodhet një person të mos përkeqësohet pa arsye, madje të mos mohohen të drejtat e fituara, interesat apo pritshmëritë e ligjshme.

Parimi i sigurisë juridike gjithashtu presupozon, se në rastet kur për shkak të veprimeve të institucioneve, të autoritetit shtetëror të drejtat e personit janë cenuar, personit duhet t'i garantohet një mbrojtje ligjore efektive e këtyre të drejtave. Kushte të nevojshme të kësaj mbrojtjeje janë dhe pavarësia dhe paanësia e gjyqtarëve dhe e gjykatave, të cilat janë të rëndësishme në sigurimin e sigurisë juridike për çdo anëtar të shoqërisë.

Parimi i sigurisë juridike është trajtuar dhe nga jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese, në vendimin nr.34, datë 20.12.2005 ku thuhet, se një nga elementet më esenciale të parimit të shtetit të së drejtës është dhe ai i sigurisë juridike, i cili ndër të tjera ka si kërkesë të domosdoshme faktin që ligji në tërësi, pjesë apo dispozita të veçanta të tij, në përmbajtjen e tyre duhet të jenë të qarta, të përcaktuara dhe të kuptueshme. Sigurisht që ato nuk mund të parashikojnë çdo rast që mund dhe duhet të lindë nga njohja dhe zbatimi i tyre në praktikë. Prandaj, në radhë të parë është detyrë e gjykatave apo e organeve të tjera shtetërore e shoqërore, të ngarkuara me ligj, që mangësi të caktuara të një ligji t'i plotësojnë natyrshëm përmes interpretimit dhe zbatimit të tij në praktikë. Por, që të realizohet një gjë e tillë, ligji duhet kuptuar saktë dhe drejt. Prandaj, duhet të dalë qartë qëllimi i hartimit të tij. Ai duhet të përcaktojë mjetet e ndërhyrjes, subjektet të cilave u drejtohet, raportet e caktuara të sjelljes dhe mënyrën e zbatimit të tij. Rezultati që synohet duhet të jetë i pritshëm dhe pasojat e parashikueshme për subjektet të cilave u drejtohet ligji në tërësi, ose dispozita të veçanta të tij.

Duke u shkëputur nga kjo trajtesë konstatoj se shumica nuk ka vlerësuar faktet, se Gjykata Popullore e Rrethit Durrës, me vendimin nr.172, datë 22.1.1961 ka vendosur njohjen e paditësit Petro Kisi si trashëgimtar në 4/8 pjesë të pasurisë së trashëgimlënëses, motrës së tij Maria Leka, që ka vdekur në Tiranë më 18 korrik 1944. Ky vendim është gjykuar në shkallë të dytë dhe nga Gjykata e Qarkut Durrës, që me vendimin nr.114, datë 25.4.1961 ka vendosur lënien e tij në fuqi.

Veç këtij fakti, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, vendimin e tyre nr.4, datë 23.1.2007 e kanë marrë në përputhje me zgjidhjen që i ka dhënë kësaj çështjeje vendimi gjyqësor i formës së prerë nr.184, datë 11.3.1961 i Gjykatës Popullore Durrës, që kishte fuqi detyruese konform nenit 451/a të Kodit të Procedurës Civile.

Për këtë arsye, në vendimin objekt shqyrtimi është trajtuar problemi i zbatimit të ligjit material dhe është pranuar se duhej zbatuar ligji i kohës, përfundim ky i bazuar në vendimin nr.184, datë 11.3.1961 të Gjykatës Popullore Durrës. Sipas vendimit të lartpërmendur, që është lënë në fuqi me vendimin nr.114, datë 25.4.1961 të Gjykatës së Qarkut Durrës, është përcaktuar se pavarësisht se trashëgimlënësja M. Leka ka vdekur në kohën kur ligji i aplikueshëm është Kodi Civil i vitit 1929, për shkak të hyrjes në fuqi të ligjit të mëvonshëm, rrethi i trashëgimtarëve nuk do të përcaktohet me ligjin e çeljes së trashëgimisë, por me ligjin që është në fuqi. Sipas nenit 62, të ndryshuar me nenin 27 të ligjit nr.3169, datë 26.10.1960, që ka ndryshuar dekretin mbi trashëgiminë, të vitit 1954, ky dekret zbatohet dhe për trashëgimitë që janë çelur para hyrjes së tij në fuqi. Ky problem, i parë në këtë këndvështrim, rezulton se problemi që diskutohet ka të bëjë me zbatimin e ligjit material, gjë që nuk është i lidhur direkt me standardet e procesit të rregullt ligjor për të cilat bën fjalë neni 131/f i Kushtetutës.

Anëtarë: Fehmi Abdiu, Xhezair Zaganjori.